



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. Prot. _____ .

Tiranë, më ____ / ____ / 2025

Lënda: Mbi Performancën Financiare Buxhetore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2024.

Drejtuar: **MINISTRISË SË FINANCAVE**

TIRANË

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), në zbatimin të buxhetit të vitit 2021, është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010, "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*". Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me performancën financiare buxhetore, ka vepruar me korrektësi në zbatim të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06. 2008 "*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", ndryshuar , të ligjit "*Për Buxhetin e vitit 2021*", ndryshuar, në vijim Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 2 datë 06. 02. 2012, "*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit*", ndryshuar.

Programi "Planifikim, Menaxhim dhe Administrim"

Buxheti i akorduar për këtë program është në funksion të realizimit të politikës së përcaktuar në Deklaratën e Politikës së Programit: Organizimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme për mirëfunksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; përafrimi dhe harmonizimi i legjislacionit në fushën e zbatimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit me legjislacionin e vendeve të tjera të bashkimit europian; sigurimi i zbatimit të legjislacionit ekzistues dhe hartimi i strategjive për realizimin e këtij synimi; vendosja e marrëdhënjëve dhe hartimi marrëveshjeve të bashkëpunimit me të gjithë aktorët që ndikojnë në zbatimin e kërkesave ligjore në fushën e zbatimit të parimit të barazisë; nxitja dhe ndërgjegjësimi i komuniteteve që kanë interes të drejtpërdrejtë si dhe të gjithë shoqërisë mbi mundësitë e zbatimit të parimit të mësipërm, për të garantuar maksimalisht të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.



Në zbatim të ligjit “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2024”, po Ju raportojmë mbi performancën e produkteve të buxhetit për periudhën Janar - Dhjetor 2024, sipas modeleve standarte të monitorimit.

Gjithashtu ky buxhet ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është akorduar një fond prej **72.500,00 (në mijë lekë)** për vitin 2024. Totali i vlerës së akorduar përbëhet nga:

Fondi i Pagave:	50. 400	<i>mijë lekë (zëri 600)</i>
Fondi i Sigurimeve Shoqërore:	8. 730	<i>mijë lekë (zëri 601)</i>
Fondi për Shpenzime Operative:	12. 370	<i>mijë lekë (zëri 602-606)</i>
Fondi për Investime:	1. 000	<i>mijë lekë (zëri 231)</i>

Nga fondi i planifikuar për 12-mujorin që është **72.500,00 (në mijë lekë)**, për periudhën e raportuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka realizuar vlerën buxhetore dhe jashtë buxhetore **70.196,15 në mijë lekë** ose **96,82 %** të buxhetit të akorduar.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore, (zëri 600-601), në zbatim të strukturës organizative të miratuar me Vendimin e Kuvendit Nr. 34 datë 20. 05.2010 “Për Miratimin e Strukturës, Organikës dhe Kategorizimit të Pozicioneve të Punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ndryshuar, numri mesatar i punonjësve është realizuar 34 nëpunës, nga 34 të miratuar.

Nga fondi i pagave, sigurimeve shoqërore dhe shpërblimeve të planifikuar prej **59.130,00 (në mijë lekë)** për këtë periudhë, është realizuar **58.183,99 (në mijë lekë)** për paga dhe për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore ose **98,40 %** e fondit mujor të planifikuar në të dy zërat bashkë.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zëri 602-606); për 12-mujorin e vitit 2024, është planifikuar në vlerën **12.370 në mijë lekë**. Për periudhën respektive është realizuar vlera prej **11.295,08 (në mijë lekë)** ose **91,31 %**, e fondit të vitit të planifikuar.

Fondi për shpenzim investime (zëri 231); nga vlera e përgjithshme prej **1.000 (në mijë lekë)** për periudhën e raportuar, është realizuar vlera prej **717,08 (në mijë lekë)** ose **71,71 %**, e fondit të vitit të planifikuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Formati nr 9

Realizimi dhe monitorimi i përdorimit të fondeve publike në nivel të përgjithshëm programi dhe realizimi ka qënë në masën **96,82 %**.

Aneksi nr 9

Për Aneksin nr. 9 gjeni bashkëlidhur Formatet nr. 6, 7, 8, 9 dhe 10.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Konc.: E. LILI

Pranoi: A. PETI